

Rihapet thirrja për Bursa për studentë në Programin Erasmus+ në Universitetin e Romës “Foro Italico”, Itali

Në kuadër të Programit Erasmus+ rihapet thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës në Universitetin e Romës “Foro Italico” në Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e parë, por ata duhet të jenë të paktën të regjistruar në vitin e dytë të studimeve të tyre);

Kohëzgjatja e bursave:

- o Bachelor (5 muaj)

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universitetin e Romës “Foro Italico” klikoni në adresën:

<http://www.uniroma4.it/?q=taxonomy/term/74>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (deri në 850 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni këtij linku:

http://ec.europa.eu/programm.../erasmus-plus/.../distance_en.htm

Midis 100 dhe 499 KM 180 EUR

Midis 500 dhe 1999 KM 275 EUR

Midis 2000 dhe 2999 KM 360 EUR

Midis 3000 dhe 3999 KM 530 EUR

Midis 4000 dhe 7999 KM 820 EUR

8000 KM ose më shumë 1100 EUR

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e nevojshme për aplikim:

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët **Bachelor**:

- ✓ CV;
- ✓ Foto personale 4 copë;
- ✓ Kopje e mjetit të identifikimit (ID/Pasaportës);
- ✓ Vërtetim studenti;
- ✓ Listë notash në anglisht;
- ✓ Letër Motivimi;
- ✓ Letër reference nga nje pedagog me kategorine “Profesor”
- ✓ Certifikatë e gjuhës së huaj*; (jo obligative)

* Universitetin e Romës “Foro Italico” ofron kurset e studimit në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane, ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B1. Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Romës “Foro Italico” lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Kriteret mbi bazën e të cilave do të përzgjidhjet student fitues janë:

- 🚩 Të njohë gjuhën angleze/italiane vlerësuar nga komisioni special për intervistën;
- 🚩 Të këtë nitën mesatare të 3 viteve Bachelor mbi 8.

Afati për aplikim: 27.03.2016

Periudha e mobilitetit: Studentët e përzgjedhur për të ndjekur këtë program mobiliteti do të fillojnë mësimin për një periudhë 5 mujore ndërmjet datave 1 Prill 2016 – 31 Dhjetor 2016.

I gjithë procesi i aplikimit kryhet online.

Për të aplikuar dergoni me email dokumentat e skanuar në formatin pdf. në adresën: sshabanaj@ust.edu.al;

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: sshabanaj@ust.edu.al

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron Suksese në aplikim!